



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1416 / Prot.
8

Vlorë më 27.06.2025

VENDIM

Nr. 48, datë 27.06.2025

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS SË STUDENTES SË FSHH-SË PËR NJOHJEN E
PAGESËS SË KRYER NË VITIN AKADEMIK 2015–2016, PËR PROGRAM TË
PAMIRATUAR ZYRTARISHT, DHE APLIKIMIN E SAJ NË VITIN AKADEMIK
2024–2025 NË UV**

Në mbështetje të nenit 49, të ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë kërkesës së rektorit të UV-së ardhur me shkresë nr.1416/1, prot, datë 20.05.2025, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 27.06.2025,

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e studentes së FSHH-së, për njohjen e pagesës për një program të studimit gjatë vitit akademik 2015–2016, program i cili nuk u miratua zyrtarisht për arsye administrative.
2. Pagesa e kryer në atë periudhë nuk mund të njihet si kompensim financiar apo zbritje e detyrimeve të tjera aktuale për vitin akademik 2024–2025.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Sekretarisë mësimore së FSHH-së në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

SOTIR NIKOLLA





Bilic 22.05.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTOR

Nr. 1416 / Prot.

Vlorë, më 20.05.2025

Lënda: Kërkesë për njohjen e pagesës së studentes Diela Bihuci në programin e ri të studimit për vitin akademik 2024-2025

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI"

Z. SOTIR NIKOLLA

KËTU


Bazuar në shkresën me nr.290/2 prot, datë 04.04.2025, protokolluar pranë nesh me nr.1113 prot, datë 07.04.2025 me lëndë: "Përcjellje e problematikës së studentes Diela Bihuci" dhe në shkresën me nr.1416 prot, datë 14.05.2025 të Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave, Ju përcjell për shqyrtim problematikën e studentes Diela Biluci për njohjen e pagesës për vitin akademik 2024-2025.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, gjeni dokumentacionin përkatës.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!

REKTOR

Prof. Dr. Aurela SALIAJ



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KURRIKULAVE DHE STATISTIKAVE

Nr. 1416 Prot.

Vlorë më, 14.04.2025

Lënda: Njohjen e pagesës së studentes në programin e ri të studimit për vitin akademik 2024–2025.

PROF. DR. AURELA SALIAJ

REKTORIT TË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË

KËTU

Referuar shkresës së Fakultetit të Shkencave Humane me nr. 290/1 prot, datë 04.04.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1113 prot, datë 07.04.2025 në lidhje me problematikën e studentes Diela Bihuci, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së studentes, konstatojmë sa më poshtë:

Studentja Diela Biluci është regjistruar në programin e studimit Master Profesional në Cikël të Ulët me Profil Minor Parashkollor, viti akademik i regjistrimit: 2015-2016.

Studentja ka ndjekur rregullisht programin Master Profesional në Cikël të Ulët me Profil Minor Parashkollor dhe ka **përmbyllur detyrimet akademike dhe financiare** përkatëse.

Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) nuk i ka gjeneruar numri matrikullimi sepse diploma e ciklit të parë të studimeve nuk plotëson kërkesat ligjore.

Studentja është diplomuar në programin Bachelor në Arsimin fillor pranë "Albania University" ndjekja e këtij programi nuk u njoh dhe si pasojë studentja nuk është pajisur me diplomë.

Në vitin akademik 2024–2025, studentja është regjistruar në një program tjetër studimi, në programin Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe bazuar në faktin se ka kryer më parë pagesën për një program që nuk u njoh zyrtarisht për arsye administrative të pavarura prej saj, **kërkohej njohja e pagesës së mëparshme si e vlefshme për programin e ri të ndjekur në këtë vit akademik.**

Bashkëlidhur shkresa e Fakultetit të Shkencave Humane me nr. 290/2 prot, datë 04.04.2025 "Përcjellje e problematikës së studentes Diela Bihuci, Departamenti i Edukimit".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËSE

Belinda Dauti

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

per mbetje
Sek. Kërkimshkencore dhe
Shkencash



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEKANI

1113

04.04.2025

Nr. 292/ Prot.

Vlorë, më 04.04.2025

Lënda: Përcjellje e problematikës së studentes **Diela Bihuci**, Departamenti i Edukimit.

PROF. DR. AURELA SALIAJ,

REKTORE E UV-së

KËTU

Në mbështetje të nenit 42, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 7 të Nenit 7 të Rregullores së Brendëshme të UV-së, po Ju përcjellim problematikën për studenten e regjistruar në programin e ciklit të dytë, **Diela Bihuci**, Departamenti i Edukimit.

Bashkëlidhur shkresat përkatëse të përcjella nga sekretaria mësimore, FSHH.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DEKAN

Prof. Dr. Roland Zisi



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Nr. 280 / Prot.

Vlorë, më 03.10.2025

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE
PROF. DR. ROLAND ZISI

Lënda: Përcjellje problematike për studenten Diela Bihuci.

Bashkëlidhur po Ju përcjellim problematikën e përcjellë nga Sekretaria e Departamentit të Edukimit, për studenten Diela Bihuci.

Bashkëlidhur dokumentacioni.

KRYESEKRETARE
Anila LULA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Nr. 280 Prot.

Vlorë, më 03.04.2025

Lënda: Njohje e pagesën për programin Master Profesional **Diela Bihuci**, Departamenti i Edukimit

ZNJ. ANILA LULA
KRYESEKRETARES SË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE

Për dijeni: Dekanit Prof. Dr. Roland Zisi
Fakulteti i Shkencave Humane

Bashkëngjitur po ju përcjellim problematikën e studentes Diela Bihuci.

Është regjistruar si studente pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit në programin e studimit *Master Profesional në Cikël të Ulët me Profil Minor Parashkollor* në vitin akademik 2015-2016. Ka frekuentuar rregullisht dhe ka shlyer gjithë detyrimet akademike dhe financiare të programin përkatës. Është diplomuar më datë 13.04.2017, por nuk është pajisur ende me kartonin e diplomës për mungesë të matricullimit.

Problematika e ardhur nga ministria konsiston në: *"mungesën e një diplome të rregullt në ciklin e parë të studimeve. Studentja është diplomuar në programin e parë Bachelor në Arsimin Fillor pranë Universitetit "Albania University" dhe diploma e saj nuk plotëson kërkesat ligjore"*.

Për këtë arsye kjo studente nuk është pajisur gjatë kësaj kohe me numër matriculimi dhe për rrjedhojë edhe me diplomë në programin master. Duke qënë se përgjigja nga MAS ishte negative për tu pajisur me diplomë, kjo studente ka aplikuar përsëri në master për vitin akademik 2024-2025 me një diplomë të rregullt Bachelori. Kërkon nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë që ti njihen pagesat që ka bërë në masterin që ka frekuentuar në vitet 2015-2017.


Ju lutem si duhet të veprojmë në rastin e kësaj studenteje.

Bashkëngjitur kërkesa shkrese do të gjeni:

- Vërtetim notash cikli i dytë
- Vërtetim diplomimi
- Problematikat e ardhura nga ministria
- Kthim përgjigje studentet nga MASR
- Foto të faturave të pagesës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE MËSIMORE E DEPARTAMENTIT TË EDUKIMIT
SUELA BALILAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË

TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E KONCEPTIMIT DHE FIZIBILITETIT TË PROJEKTEVE TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 9522/Prot.

Tiranë, më 25.09. 2018

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. DIELA BIHUCI


Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 13.09.2018, e administruar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 9522 prot., datë 17.09.2018, ju bëjmë me dije se, duke gjykuar nga kopja e diplomës bashkëlidhur kërkesës, diploma e lëshuar në datën 27.07.2013 nga Filiali Berat i Universitetit privat "Albanian University" për znj. Diela Bihuci për programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin fillor" nuk plotëson kërkesat ligjore:

1. Zn. Bihuci është regjistruar (ka filluar studimet) në një program studimi të palicencuar,
2. Forma e diplomës së lëshuar nuk është regjistruar, si një kërkesë ligjore, e përcaktuar në pikën 6 të nenit 31 të Ligjit nr. 9741 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, (në fuqi në kohën kur është lëshuar diploma) dhe pikën 3 të nenit 91 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Alqi Kushi



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: www.arsimi.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Nr. Prot.

Vlorë, më 28. 08. 2017

V È R T E T I M

Vërtetojmë se: Znj. Diela Bihuci, ka përfunduar studimet në ciklin e dytë të studimeve Master profesional në "Mësuesi në Ciklin e Ulët me profil minor Parashkollor" me kohë të plotë, pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, prej vitit 2015 deri në vitin 2017. Ka shlyer detyrimet akademike, financiare si dhe ka mbrojtur gjuhën e huaj sipas ligjit në fuqi.

Datë Diplomimi: 13. 04. 2017

E leshojmë këtë vërtetim me kërkesën e të interesuarit.

Florida YMERAJ
Sekretare

Suela BALILAJ
Kryesekretare

Prof. AS. DR. ALEKS. TRUSHAJ



Ky dokument është pëpiluar në tri kopje origjinale.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Vlorë më 17. 04. 2017

VËRTETIM NOTASH

Vërtetojmë se Znj. Diela Bihuci, ka ndjekur studimet në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë në programin Master profesional në "Mësuesi në Ciklin e Ulët me profil minor Parashkollor" gjatë periudhës akademike 2015-2017, dhe është diplomuar sipas planit mësimor.

Nr.	Kodi	Emërtimi	Kredite	Nota
1	HUM 460	Bazat kulturore të edukimit	8	7(shtatë)
2	EDU 441	Bazat pedagogjike të edukimit	8	6(gjashtë)
3	EDU 470	Kërkimi shkencor	10	6(gjashtë)
4	BIO 510	Mësimdhënia në shkencat e natyrës	10	6(gjashtë)
5	EDU 430	Bazat psikologjike të edukimit	8	6(gjashtë)
6	EDU 440	Edukimi i të drejtave të njeriut	10	7(shtatë)
7	HUM 410	Komunikimi në klasë	8	5(pesë)
8	EDU 425	Mësimdhënia e historisë dhe gjeografisë	8	5(pesë)
9	ENGH 550	Gjuhë e huaj	6	5(pesë)
10	EDU 498	Provimi formimi	14	7(shtatë)


Diplomuar me dt. 13. 04. 2017

Florida YMERAJ
SEKRETARE

Suela BALILAJ
KRYESEKRETARE

Prof. As. Dr. Aleks TRUSHAJ

DEKAN



Të dhënat e këtij vërtetimi janë përgjegjësi e sekretarisë mësimore të Fakultetit të Shkencave Humane pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

MP - KP	Mësuesi për Ciklin e Ulët me Profil Minor Parashkollor	16.11.2015	Diela	Zoo	Bihuci	12.09.1983	Dukat,Vlorë	135912660	Kartë ID	Albanian University	2015-2016	Nevojitet fotokopje e diplomes se ciklit te pare me te cilen eshte pranuar
MP - KP	Mësuesi për Ciklin e Ulët me Profil Minor Parashkollor	16.11.2015	Diela	Zoo	Bihuci	12.09.1983	Dukat,Vlorë	135912660	Karte Ident	Albanian University	2015-2016	Ky student ka filluar programin e studimit ne ciklin e pare tek IAL Albanian University 8 muaj perpara licensimit te këtij programi . Studenti është regjistruar me date 12.10.2010 nderkohe programi eshte licensuar me Urdher Nr. 251, date 02.06.2011. Lutemi si institucioni pranues i studenteve beni verifikimet e duhura dhe na njoftoni nese duhet ta pajisim me NIM kete student.



VENETO BANKA

Accanto alla
di Spazio
IDM

18.05.15
00007517

TEKARHURA DE FIESAR (M. LORE)

per azione
non pagata da di la banca per tutti
alim master professional

SS.000.000.000

Firma a clientit / Firma cliente